

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari i vetëm Ilir Bytyqi, si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtërpcë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.38/16 të datës 07.06.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit [REDAKTUAR] si dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. [REDAKTUAR], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datën 05.12.2017, morri dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtërpcë, nga i ati [REDAKTUAR] nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] serb, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, me profesion ekonomist, i gjendjes së mesme ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Se më datën 09.04.2016, në shtëpinë e tij në Shtërpcë, ka poseduar paautorizim armët në kundërshtim me ligjin mbi armët në atë mënyrë që me rastin e zbatimit të urdhër kontrollit nga ana e policisë janë gjetur një pistoletë "Ekol Tuna", modeli 635, numër serik T6120692, me një karikator me 6 fishek, një armë e prodhimit Rus e modelit "Toz 78-05", me numër serik 0600549, me tre karikator dhe 178 copë fishek të kalibrit 5.6 mm, një radiolidhje, një maske e fytyrës e ngjyrë e zezë, një thikë dhe tri uniforma ushtarake, të cilat i sekuestrohen përkohësisht nga policia.

me të cilën kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 3,6, 17,21,41,43,45,46, dhe 73 të KPRK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së, të pandehurin e

## GJYKON

- **DËNIM ME GJOBË**, në lartësi prej 600 Euro /gjashtëqind/, të cilin gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 Muaj, në 3 këste nga 200 € /dyqind/ për Muaj, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Në rast se i pandehuri dështon ta paguaj me kohe njërin nga këste e sipërcekur, gjykata mundësin e kësteve mund ta revokoj.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.
- Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma-revolva “Ekol Tuna”, modeli 635, numër serik T6120692, me një karikator me 6 fishek, një armë e prodhimit Rus e modelit “Toz 78-05”, me numër serik 0600549, me tre karikator dhe 178 copë fishek të kalibrit 5.6 mm, një radiolidhje, një maske e fytyrës e ngjyrë e zezë, një thikë dhe tri uniforma ushtarake.
- Në bazë të nen. 450 par.1 dhe par. 2 të KPRK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € /pesëdhjetë/ në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.38/16 të datës 07.06.2016, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR]

K. Shterpce, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale si dhe duke pasur parasysh edhe udhëzimet e gjykatës se Apelit, mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 05.12.2017, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Valdet Avdiu, mbeti në tërsi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj si dhe të i konfiskohen sendet e propozuara ne akuzë.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale sipas te gjitha pikave për të cilën e ngarkon aktakuza, si dhe më vjen keq për këtë vepër penale, ndihem thellë i penduar dhe premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, kurse gjatë matjes së dënimit i propozoj gjykatës që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi me autorizim i të pandehurit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR] në lidhje me pranimin e fajësisë deklaroni: ne pikëpamje te caktimit te dënimit i propozoj gjykatës ti këtë parasysh rrethanat si ne vijim arma qe është gjetur te i pandehuri është sportive dhe e njëjta shfrytëzohet për qëllime rekreative dhe i njëjti këtë arme e ka gjetur ne rekreacion si dhe i vije keqe qe nuk e ka dorëzuar ne stacionin policor ndërsa sa i përket maskës dhe uniformes ato janë te papërshkrueshme nga uji dhe te njëjtat i ka shfrytëzuar për shëtitje në malin Sharr dhe ne baze të të gjeturave të shqiptoj një dënim me të ulët.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që e akuzuara ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;



- pranimi është bërë vullnetarisht;

- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin fillestar: urdherkontrolli nr. UGJK.29/16 dt. 08.04.2016, procesverbali mbi kontrollin e lokaleve dhe personave dt. 09.04.2016, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve dt. 09.04.2016, raporti i forenzikës dt. 09.04.2016 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lendes.

- të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe gjyqtari vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*)

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se i akuzuari deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht

rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma-revolva "Ekol Tuna", modeli 635, numër serik T6120692, me një karikator me 6 fishek, një armë e prodhimit Rus e modelit "Toz 78-05", me numër serik 0600549, me tre karikator dhe 178 copë fishek të kalibrit 5.6 mm, një radiolidhje, një maske e fytyrës e ngjyrë e zezë, një thikë dhe tri uniforma ushtarake.


Në bazë të nen. 450 par.1 dhe par. 2 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 € /katërdhjet/ në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.2700/17 me datë 05.12.2017**

Zyrtare ligjore  
Kadisha Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



**Këshilla juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditëve, Gjykatë së Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.